

Data 24/08/2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët, Faza IV - Materiale ndërtimi.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34144910-0, 34114400-3

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës/marrëveshjes kuadër: 276,191,667 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në Euro 2,974,280.28.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika ”b”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjeshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: ”b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin, natyrën, sasitë dhe vlerën e kontratës.

Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme për kontrata të ngjashme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Shënim: *(Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).*

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin teknik, si më poshtë:

Stafi teknik/Ekspert	
1 një	Inxhinier Elektrik
1 një	Inxhinier Elektronik
1 një	Inxhinier Mekanik

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.2 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetedeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimin, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe neni 40 pika 5/b te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me one te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates. Kriteri per Stafin, lidhet ngushtesisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe zwrat e mjeteve/pajisjeve. Numri i stafit kryesor teknik eshte percaktuar nga pikepamja e natyres teknike te kontrates me qellimin per te patur nje rezultat sa me te mire ne mbarevajtjen dhe realizimin e kontratws. Operatoret ekonomike duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmerine, per te zbatuar kontraten.

Argumentimi Stafit

Eksperti	Fusha kryesore e përgjegjësisë
1 një Inxhinier Elektrik	Infrastrukturë elektrike, karikues DC 50/150 kW, furnizim me energji, mbrojtje elektrike, tokëzim, SPD/RCD/MCB, sisteme fotovoltaike, bateri dhe integrim energjetik
1 një Inxhinier Elektronik	ITS, telematikë, RTPI, CCTV, APC, SOS/Intercom, rrjete IP, pajisje elektronike, komunikim, integrim hardware/software Platforma ITS, CAD/AVL, RTPI, VMS, EMS, CMMS, API, databaza, cloud/on-premise, cybersecurity dhe integrimet
1 një Inxhinier Mekanik	Autobusët/minibusët elektrikë, strukturat mekanike, sistemet e frenimit, pezullimit, drejtimit, HVAC, komponentët mekanikë dhe mirëmbajtja

2.3.3 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet dhe pajisjet e mëposhtme për kryerjen e furnizimit, me qëllim realizimin e objektit të kontrates:

Nr	Mjetet	Sasia
1	Kamion me vinç	1 copë

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

-Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).

-Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata ku të specifikohet afati i kontratës.

-Per mjetet e marra me qira qe shenohen ne regjistra publik, duhet te paraqitet dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë furnizimin, targimi i mjeteve, shërbimin e transportit dhe montimit të stacioneve të karikimit, shërbimin e transportit dhe montimit të stacioneve smart në bashkine Berat.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se mallrat që do të dorëzojnë do të jenë sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe të marrin përsiper levrimin, shërbimin e transportit, montimin, si dhe targimin e mjeteve në bashkinë Berat. Deklarata është dëshmi që verteton marrjen e përgjegjesive nga operatorët ekonomikë dhe krijon një besueshmeri dhe siguri për autoritetin, për furnizimin dhe transportimin e mjeteve, pajisjeve prane bashkisë Berat, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës vendore me qëllim përmirësimin e jetës së komunitetit që njehsite vendore përfaqësojnë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë, skica teknike, fletë teknike ose dokumentacion tjetër teknik nga prodhuesi, ku të evidentohen karakteristikat teknike të mjeteve/pajisjeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Katalogu, skica teknike, fletë teknike ose dokumentacion tjetër teknik nga prodhuesi janë dëshmi që verteton marrjen e përgjegjesive nga operatorët ekonomikë dhe krijon një besueshmeri dhe siguri për autoritetin, për furnizimin e mallrave.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim për periudhën e garancisë së mjeteve/pajisjeve sipas specifikimeve teknike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e mjeteve dhe pasjisjeve, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë furnizimin me cilësi për mos të qenë i detyruar të zëvendësojë apo riparojë.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter garanton sigurinë e mjeteve/pasjisjeve nga prodhuesi ose distributori. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Shënim:

Mbi mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera

Në mbështetje të nenit 84, pika 7, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 90, pika 6, të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë nuk mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriteret që lidhen drejtpërdrejtë me realizimin e proceseve kryesore të kontratës, konkretisht:

Kapacitetin teknik përvojën e mëparshme të ngjashme;

Kapacitetin teknik mjetet dhe stafin teknik

kapacitetin financiar;

Këto kapacitete konsiderohen thelbësore për realizimin e kontratës, pasi lidhen drejtpërdrejt me furnizimin e mjeteve dhe pajisjeve, përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe kërkesat ligjore, si dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë gjatë realizimit të furnizimit objekt kontrate. Autoriteti Kontraktor vlerëson se mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për këto kriterë mund të cenojë realizimin efektiv dhe të besueshëm të kontratës. Për këtë arsye, këto kapacitete duhet të disponohen dhe të angazhohen drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik ose anëtar i përkatës i BOE që do të realizojë furnizimin, me qëllim garantimin e përgjegjshmërisë, cilësisë së ekzekutimit dhe minimizimin e riskut gjatë zbatimit të kontratës

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si me poshte:

- Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në çmim

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. Keto specifikime përcaktojnë kërkesat minimale teknike për projektimin, prodhimin, furnizimin, instalimin, testimin, komisionimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve/pajisjeve/stacioneve të karikimit etj, për të realizuar Sistemin e Integruar të Transportit Publik Elektrik dhe Inteligent në Qytetin e Beratit.

Shënim: Për zërat në DST që mund të jete paraqitur markë/brand, si dhe në specifikimet teknike janë përmendur markë/brand operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përfitimit të ofertës ekonomike.